

Raport Muaji Qershor 2019 për fondin Credins Premium

Shoqëria Menaxhuese e Fondit: Credins Invest sh.a.

Data e lançimit të fondit: 01 Korrik 2016

Objektivi i investimit:

Fondi Credins Premium ka objektiv të maksimizojë të ardhurat tuaja, duke ruajtur principalin dhe likuiditetin. Portofoli i Fondit CREDINS PREMIUM, në përputhje me Politikën e Investimit, do të përbëhet kryesisht nga obligacione dhe bono të Qeverisë së Republikës së Shqipërisë të denominuara në Lek, si dhe mjete monetare dhe ekuivalente të tyre në bankat e nivelit të dytë.

Fondi i adresohet investitorëve që kërkojnë:

- ✓ një normë kthimi më të lartë se produktet bankare,
- ✓ likuiditetin që i mungon këtyre produkteve.

Profili i rrezikut dhe përfitimit

Ecuria e normës së kthimit të Fondit varet nga lëvizja e normave të interesit të bonove dhe obligacioneve të Republikës së Shqipërisë. Historikisht këto norma kanë treguar luhatshmëri të ulët.

Rrezik i ulët

Rrezik i lartë

Përfitimet tipike më të ulëta

Përfitimet tipike më të larta

1	2	3	4	5	6	7
---	---	---	---	---	---	---

Fondi CREDINS PREMIUM ka një profil rreziku në nivelin 2, pra të ulët.

Të dhëna kryesore për Fondin, 30 Qershor 2019

Vlera Neto e Aseteve	2,985,485,498.41
Cmimi i kuotës	1,270.9788
Kohëzgjatja e Modifikuar	2.26 vjet
Kthimi nga investimi (30.06.2018-30.06.2019)*	8.5%

* Tarifa e administrimit është zbritur përpara llogaritjes së kthimit nga investimi.

Depozitat Bankare

Depozita Bankare si klasë aseti përmban rrezikun e kredisë së bankës dhe rrezikun e rëzimit në momentin e maturimit të saj. Rreziku i rëzimit nënkupton uljen e normës së interesit kur depozita rivendoset me të njëjtin maturitet.

Obligacionet dhe Bonot Qeveritare

Këto asete janë të emetuara nga Qeveria agjensitë apo ndërmarrje të sponsorizuara nga Qeveria. Megjithatë, qeveritë nuk garantojnë pagesën e interesit apo principalit. Obligacionet apo Bonot qeveritare janë subjekt i rrezikut nga normat e interesit dhe kanë nota krediti (“rating”) të ndryshme. Bonot përmbajnë rrezik nga interesat më të lartë se obligacionet me të njëjtën kohë deri në maturim.

**Për më tepër informacion rreth rreziqeve të Fondit, ju lutem referojuni seksionit përkatës në Prospektin e Fondit Credins Premium.*

Kostot dhe Pagesat


Pagesat përdoren për të paguar kostot e administrimit të Fondit, duke përfshirë kostot e marketingut dhe shpërndarjes së kuotave të Fondit. Pagesat që kryhen çojnë në ulje të rritjes potenciale të investimit.

Tarifa e hyrjes	0%
Tarifa e daljes	0%
Tarifa e administrimit	1% në vit e VNA të Fondit
Komisione të transfertës nga shlyerja e kuotave	0 Lekë
Kosto të tjera:	
Kosto të transaksioneve për investimin e aseteve të fondit	sipas kushteve të punës të palëve ndërmjetësuese
Tarifa e auditimit vjetor të fondit	sipas kushteve të punës së kompanisë së auditit
Tarifa e depozitarit	0.153% në vit e VNA
Tarifa e AMF	0.05% në vit e VNA

Shpërndarja e Instrumentave si përqindje e Vlerës Neto të Aseteve, 30 Qershor 2019

Shpërndarja e Instrumentave	ALL	% Vlerës Neto të Aseteve
Obligacione	1,847,387,336.63	61.88%
Bono Thesari	258,699,399.15	8.67%
Mjete monetare dhe ekuivalente të tyre	904,209,068.66	30.29 %


Shpërndarja e Instrumentave sipas Llojit, më 30 Qershor 2019



Ankandet e titujve qeveritarë dhe normat e interesit

Qeveria e Republikës së Shqipërisë emeton letrat me vlerë në periudha relativisht të rregullta dhe të shpeshta. Në përputhje me materialet informuese të publikuara nga Ministria e Financave, ankandet për bonot e thesarit me afat 3-mujor dhe 6-mujor organizohen një herë në muaj, ndërsa ato 12-mujore organizohen çdo dy javë. Duke përjashtuar ankandet e obligacioneve 2-vjeçare, të cilat zhvillohen një herë në muaj, ankandet e obligacioneve të tjera (3,5,7,10-vjeçare) zhvillohen me një frekuencë të përafërt prej 3 muajsh.


Ecuria e normave afatshkurtra



Gjatë muajit Qershor u zhvilluan dy ankande për bonot 12-mujore. Ankandi i datës 04 Qershor shënoi rritje nga 1.373% në 1.460%. Ndersa rezultati i ankandit te dates 18 Qershor shenoi rritje ne 1.678%. Për bonot 3-dhe 6-mujore nuk u zhvilluan ankande gjatë muajit Qershor.


Ecuria e yield-eve të Obligacioneve

Ecuria e normave afatgjata



Gjatë muajit Qershor yield-i i obligacionit me afat maturimi 2 vjet ka shënuar rritje në ankand (emetim i ri), nga 1.64% në 1.99%. Ankandi i zhvilluar për obligacionin referencë 3-vjeçar shënoi rritje nga 1.757% në 2.307%. Ankandi i rihapjes i zhvilluar për obligacionin 7-vjeçar shënoi rritje nga 3.75% ne 4.24%. Gjatë muajit Qershor nuk u zhvilluan ankande për obligacionet 5 dhe 10-vjeçare.

Kthimi vjetor neto historik, në 30 Qershor 2019



Norma vjetore e kthimit për 12 muajt e fundit (30 Qershor 2018-30 Qershor 2019) ishte 8.5% nga 9.94% që ka qenë për 31 Maj 2018- 31 Maj 2019. Kjo rënie e normës vjetore i atribuohet rritjes së përgjithshme të normave të interesit për bonot dhe obligacionet Qeveritare të Republikës së Shqipërisë, që ka filluar që nga mesi i muajit Maj 2019 dhe deri në fund të Qershorit 2019. Fondi është i detyruar të regjistrojë obligacionet dhe bonot në portofol sipas vlerës së drejtë, që do të thotë kryen vlerësimin e tyre të tregut çdo ditë. Çmimi i obligacioneve dhe i bonove ka një relatë të zhdrejtë me normat e interesit. Kur normat e interesit në treg rriten, çmimi (vlera) i obligacioneve dhe bonove të mëparshme ulet dhe për rrjedhojë ulet dhe norma e kthimit për periudhën e kaluar. E kundërta ndodh kur normat e interesit ulen. Gjatë fillimit të vitit normat e interesit ranë konsiderueshëm dhe fondi rezultoi me një normë të lartë kthimi. Por këto janë lëvizje të përkohshme të normës së kthimit që shoqëron një investim në obligacione, pasi nëse investitori qëndron përgjatë gjithë maturimit të një obligacioni ai do fitojë një normë kthimi sa kuponit që është fiks dhe ri-investimi i kuponit me normat e tregut që kanë rezultuar gjatë kohës së obligacionit. Për rrjedhojë ne sugjerojmë që klientët të qëndrojnë për një kohë më të gjatë se 1-vit për të siguruar një normë të kënaqshme nga investimi. Pavarësisht nga uljet e normës së kthimit gjatë muajit Qershor 2019, norma e kthimit që nga fillimi i vitit 2019 rezulton 4.25%.

Performanca e kaluar nuk është një udhëzues, premtim apo garanci për performancën e ardhshme dhe nuk duhet të jetë faktori i vetëm i shqyrtimit gjatë zgjedhjes së një produkti. Të gjitha investimet financiare përfshijnë një element të rrezikut. Prandaj, vlera e investimit tuaj dhe të ardhurat nga ajo do të ndryshojnë. Nivelet dhe bazat e taksimit mund të ndryshojnë herë pas here. Për informacion shtesë, jeni të ftuar të lexoni Prospektin e Fondit si dhe të vizitoni web site e shoqërisë